L I G J
Nr.7854, datë 29.7.1994

PËR MIRATIMIN ME NJË NDRYSHIM TË DEKRETIT NR.894, DATË 21.7.1994 "PËR DISA SHTESA NË KODIN PENAL"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Miratohet dekreti nr.894, datë 21.7.1994 "Për disa shtesa në Kodin Penal", me ndryshimin e mëposhtëm:

- Në nenin 1 paragrafi i parë riformulohet si vijon:

"Lidhja si dhe çdo ndërhyrje tjetër e bërë pa leje në rrjetin e ujësjellësit për marrjen e ujit të pijshëm, dënohet me gjobë ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.